

ANEKSI 80

**GARANCIA PËR SHUMËN E SANKSIONEVE TË APLIKUARA PËR SHKELJEN**

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 282 të Kodit, dokumenti i garancisë duhet të përmbajë të dhëna të hollësishme për:

a) garantuesin, apeluesin ndaj të cilit del garant, përfituesin (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe shumën e përgjithshme të sanksionit/eve për të cilën/cilat lëshohet garancia, si dhe referencat e vendimit (numrin, datën dhe degën doganore që e ka nxjerrë aktin) në të cilin përcaktohet masa e penalitetit/sanksionit;

b) angazhimin e garantuesit për garantimin e vlerës së plotë të penalitetit dhe afatin e vlefshmërisë së garancisë, i cili do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga momenti i lëshimit. Ky afat mund të zgjatet rast pas rasti, sipas kërkesës me shkrim dhe nevojave së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

c) angazhimin e garantuesit për pagesën prej tij pa kushte të shumës së përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen, menjëherë pas kërkesës dhe pa qenë nevoja për argumentim të saj nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Format i garancisë është si më poshtë vijon.

**FORMATI I GARANCISË**

(Institucioni garantues)

\_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_.

**GARANCI**

**PËR SHUMËN E SANKSIONEVE TË APLIKUARA PËR SHKELJE NË FUSHËN  
DOGANORE**

Në emër të:.....

Përfituesi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Duke qënë se Apeluesi/Shoqëria \_\_\_\_\_ po ushtron ankim ndaj vendimit të Degës së Doganës \_\_\_\_\_, bazuar në nenit 282 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Duke qënë se Apeluesi/Shoqëria për marrjen në shqyrtim të ankesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të paraqesë një garanci për shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti, sipas vendimit nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ të Degës së Doganës \_\_\_\_\_, në shumën \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) lekë;

Me këtë dokument vërtetojmë se ne, \_\_\_\_\_ (institucioni garantues), marrim përsipër t'i paguajmë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, shumën totale prej \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) lekë shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhën e përcaktuar si më sipër.

Ne marrim përsipër ta kalojmë menjëherë dhe pa kushte këtë shumë në llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe pa qenë nevoja për të bërë argumentim të kërkesës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Me këtë garanci ju sigurojmë se nuk është e nevojshme t'i drejtoheni më parë Apeluesit/, Shoqërisë \_\_\_\_\_ për të realizuar pagesën në lidhje me këtë garanci.

Kjo garanci është e vlefshme 6 (gjashtë) muaj nga momenti i lëshimit. Ky afat mund të zgjatet rast pas rasti sipas nevojave dhe kërkesës me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Me mbarimin e këtij afati, kjo garanci bëhet e pavlefshme dhe \_\_\_\_\_ (institucioni garantues) është i çliruar nga çdo lloj detyrimi, në lidhje me këtë garanci.

### **Nënshkrimet e përfaqësuesve të institucionit garantues**

---